

Në mungesë të vendimarrjes së palëve të interesit, agjencive të administrimit kolektiv dhe shoqatave të përdoruesve, për lidhjen e një marrëveshjeje gjithëpërfshirëse për tarifat e shpërblimit për të drejtën e autorit, me qëllim garantimin e mbarëvajtjes së sistemit të menaxhimit kolektiv të të drejtave të autorit, Drejtoria e të Drejtës së Autorit u angazhua me Organizatën Ndërkombëtare të Pronësisë Intelektuale dhe me projektin ALSIP, Albanian-Swiss Project, për hartimin e një raporti të detajuar të ligjit për të drejtën e autorit për të përcaktuar kushtet kryesore për hartimin e metodologjisë dhe tarifave për të drejtën e autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, në përputhje të ligjit nr. 35/2016 “Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to”, i ndryshuar.

Me përfundimin e procesit të licencimit dhe ripërtëritjes së licencave të administrimit kolektiv dhe me përfundimin e draft metodologjisë, vlerësojmë se është e domosdoshme të vijojmë me procedurën e miratimit të metodologjisë për përcaktimin e nivelit të tarifave.

Njëkohësisht, sqarojmë se në zbatim të nenit 157 të ligjit, funksioni i miratimit të metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit, kryhet nga Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit. Ky këshill aktualisht nuk është i formuar, sepse kanë përfunduar mandatet e kryetarit dhe katër anëtarëve. Ata emërohen nga ministri përgjegjës për të drejtën e autorit për një periudhë katërvjeçare. Propozime për zgjedhjen e anëtarëve të KKDA-së mund të bëjnë AAK-të, shoqatat përfaqësuese të përdoruesve, si dhe çdo subjekt i interesuar.

Drejtorja për të Drejtën e Autorit, Ju propozon fillimin e procedurës për miratimin e metodologjisë dhe përcaktimin e tarifave për shpërblimin e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, si dhe emërimin e anëtarëve të KKDA-së. Procedura për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e nivelit të tarifave do të jetë publike dhe do të njoftohet në të gjitha faqet zyrtare të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

Në vijim, Ju përcjellim planifikimin për fillimin, zhvillimin dhe përfundimin e procedurës me afate kohore konkrete:

I. Faza e parë:

1. Publikimi i raportit dhe draft metodologjisë për t’u konsultuar nga publiku i gjerë, agjencitë e administrimit kolektiv, shoqatat e subjekteve përdoruese dhe të gjitha palët e interesuara.
2. Afati: Palët e interesuara kanë 30 ditë për të shqyrtuar dokumentin dhe për të paraqitur komentet ose propozimet e tyre pranë Drejtorisë për të Drejtën e Autorit.

II. Faza e dytë:

1. Përmbledhja e komenteve dhe sugjerimeve. Drejtoria për të Drejtën e Autorit përmbledh dhe

klasifikon informacionin e përcjellë nga palët e interesuara. Afati: 7 ditë pune.

2. Takim me grupet e interesit: MEKI do të zhvillojë takim me grupet e interesit për ti vënë në dijeni për fazën e konsultimit publik. Afati: 1 ditë pune.
3. Palët fillojnë negociatat për një marrëveshje gjithëpërfshirëse. Palët duhet të vendosin me shkrim në lidhje me marrëveshjen gjithëpërfshirëse për përcaktimin e tarifave dhe metodologjisë së shpërblimit.

Afati: Palët kanë në dispozicion një periudhë prej 30 ditësh për të zhvilluar negociatat dhe për të formalizuar marrëveshjen, duke filluar nga dita e nesërme e përfundimit të afatit të përcaktuar për DDA-në për dorëzimin e komenteve.

Në përfundim të fazës së tretë, rezultati i pritshëm është miratimi i një marrëveshje me shkrim bazuar në mirëkuptim dhe interesa të përbashkëta. Marrëveshja hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare dhe zbatohet për të gjithë përdoruesit e së njëjtës kategori të veprave të autorëve nga repertori i AAK-së, pavarësisht nëse ata morën pjesë në negociata ose në përfundimin e kësaj marrëveshjeje.

III. Faza e tretë:

Procedura përpara Këshillit Kombëtar për të Drejtat e Autorit. Në rast se palët nuk arrijnë një marrëveshje në përfundim të fazës së tretë, në bazë të nenit 143 të ligjit, Këshilli Kombëtar i të Drejtës së Autorit do të shqyrtojë rezultatet dhe do të miratojë tarifat dhe metodologjinë përfundimtare. Një AAK ose një shoqatë përfaqësuese e përdoruesve, i kërkon KKDA-së për të caktuar/vendosur një tarifë të përshtatshme ose për të vendosur për çdo çështje tjetër në lidhje me marrëveshjen gjithëpërfshirëse.

KKDA-ja ka detyrimin të njoftojë palët për të marrë pjesë në seancat ku diskutohet për miratimin e metodologjisë dhe masës së tarifave të shpërblimit për kategorinë e të drejtave përkatëse, të paktën 5 ditë përpara ditës së caktuar për mbledhje. Palët kanë drejtë të propozojnë dhe të japin opinionin e tyre verbalisht ose me shkrim, por në asnjë rast, nuk kanë të drejtë vote për vendimmarrje. Palët duhen të jenë aktive dhe të gatshme me përgjigjet ndaj KKDA-së për çdo informacion shtesë të kërkuar në funksion të çështjes. Çdo palë deklaron faktet dhe paraqet prova, mbi të cilat ajo bazon propozimet e saj, ose me të cilat ajo kundërshton pretendimet dhe provat e palës tjetër. Në vendimin përfundimtar, KKDA-ja mban parasysh dhe analizon propozimet ose opinionet e shprehura.

KKDA-ja publikon në vendimin e marrë edhe mendimin e arsyetuar të anëtarit/ve që kanë votuar në pakicë dhe shënon në procesverbal faktin dhe arsyet e votimit kundër. Vendimi përfundimtar i

KKDA-së publikohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Kulturës dhe në aktet e tjera të publikimeve zyrtare.

Afati: Në zbatim të nenit 144 të ligjit, kohëzgjatja e procedurës përpara KKDA-së do të jetë 45 ditë nga data e depozitimit të kërkesës.

Për të siguruar që procesi zhvillohet në mënyrë efektive dhe në përputhje me afatet, do të mbajë kontakte të vazhdueshme me palët për të ndihmuar dhe lehtësuar ecurinë e procesit.

Sa më sipër Ju përcjellim planifikimin e Drejtorisë për të Drejtën e Autorit, për zhvillimin e procedurës së miratimit të metodologjisë dhe tarifave për shpërblimin e të drejtës së autorit, të cilin e gjeni për lehtësi edhe në formë tabelare, bashkëlidhur kësaj memo.

Duke Ju falënderuar,

Shtojca 1: Procedura e përmbledhur sipas afateve.

Procedura	Përshkrimi	Data e fillimit	Data e përfundimit
Faza 1: Konsultimi publik.	- Publikimi i draftit të metodologjisë në faqen e internetit. - Konsultimi publik.	23.12.2024	24.01.2025
Faza 2: Negociatat	- Përpunim i të dhënave nga DDA.	27.01.2025	04.02.2025
	- Takim me grupet e interesit.	05.02.2025	
	- Negociatat për nënshkrimin e marrëveshjes gjithëpërfshirëse.	06.02.2025	06.03.2025
Faza 3: Vendimi i KKDA	- Procedura përpara KKDA-së.		45 ditë nga paraqitja e kërkesës